



## **Plani Strategjik 2025 - 2030**

**i**

### **Akademisë “Evolucion”**

*Prishtinë, Janar 2026*

*Plani Strategjik është aprovuar në dhjetor 2024 dhe është përditësuar në janar 2026.*

## **Përmbajtja**

1. Misioni dhe objektivat e Akademisë "Evolucion" .....	3
1.1 Misioni .....	3
1.2 Objektivat.....	4
2. Strategjia për arritjen e misionit dhe objektivave të Akademisë "Evolucion" .....	4
A. Programet e studimit/-Ekselencia akademike .....	5
B. Kërkimi, inovacioni dhe praktika kreative.....	5
C. Stafi akademik dhe administrativ.....	6
D. Studentët .....	6
E. Përshtatja ndaj ndryshimeve .....	8
F. Bashkëpunimi dhe ndërveprimi .....	8
G. Përgjegjësia sociale.....	10

## Qëllimi i këtij Plani Strategjik

Ky plan strategjik (PS) përshkruan drejtimin dhe prioritetet e nivelit të lartë të Akademisë 'Evolucion' (AE) gjatë periudhës 2025-2030.

PS gjithashtu ofron drejtime për planifikimin e njësive/departamenteve që do t'i përkthejë këto drejtime në iniciativa specifike në të gjithë AE.

Krijimi i këtij plani strategjik përfshin disa hapa të rëndësishëm konsultativë, ku të gjithë akterët në AE janë të përfshirë drejtpërdrejt duke shprehur njohuritë dhe pikëpamjet e tyre.

- Në pranverë 2024, drejtuesit akademikë dhe administrativë morën pjesë në një seminar për të mësuar rreth metodologjisë së planifikimit të ofruar nga AE. Kjo siguroi një platformë për një proces të përbashkët planifikimi.
- Bazuar në kontributin e palëve të interesuara, përpjekjet e mëparshme të planifikimit dhe kërkimit, dhe faktorët e jashtëm, grupi punues përgatiti një vlerësim të detajuar të situatës për AE. Ky vlerësim më pas informoi trendet përmbledhëse, analizën SWOT dhe çështjet strategjike.
- Gjatë angazhimit të Këshillit Drejtues dhe Këshillit Akademik, Udhëheqësve të njësive Akademike dhe akterëve të tjerë në AE së bashku zhvilluan dhe evoluan konceptet e strategjisë duke përfshirë vlerat, misionin, vizioni, qëllimet, strategjitë dhe treguesit kryesorë të Performancës.
- Njësitë Akademike, stafi dhe studentët rishikuan dhe dhanë të dhëna për konceptet paraprake.
- Këshilli Akademik dhe komisionet e formuara finalizuan më pas komponentët e përfshirë në këtë plan.
- Këshilli Akademik dhe komisionet e formuara zhvilluan diskutime mbi hapat konkrete që duhet të ndërmerren për të arritur objektivat, si pjesë e planifikimit të hapave të ardhshëm.

## 1. Misioni publik dhe objektivat institucionale

Si një institucion kredibil i Arsimit të lartë që ofron studime në fushat e artit aplikativ/ dizajnit, AE është e përkushtuar për të ofruar studime profesionale cilësore të zhvilluara në harmoni me Deklaratën e Bolonjës dhe Standardet dhe Udhëzuesit për Sigurimin e cilësisë në Arsimin e lartë (ESG).

AE ka kaluar me sukses disa cikle të vlerësimit të jashtëm në nivel institucional dhe të programeve të studimit nga Agjencia e Kosovës për akreditim (AKA), e cila është autoritet vlerësues i përmbushjes së standardeve të cilësisë (ESG) në arsimin e lartë në Kosovë dhe është anëtare e plotë e EQAR.

## 1.1 Misioni

AE krijon dhe kultivon një kulturë të veçantë, nxit procese inovative të mësimdhënies, mësimnxënies dhe kërkimit artistik të aplikuar, mbështet rritjen ekonomike dhe kulturore në vend dhe jo vetëm, dhe plotëson nevojat e një komuniteti divers/gjithëpërfshirës duke rritur dhe forcuar partneritetet me bizneset dhe arsimin e lartë si brenda dhe jashtë vendit.

## 1.2 Vizioni

Të mbetet një institucion kryesor i arsimit të lartë për edukimin dhe zhvillimin profesional të krijuesve të rinj në dizajnin e modës dhe fusha të ngjashme, i njohur dhe i respektuar në nivel kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar.

Të sigurojë një edukim të nivelit të lartë duke ofruar një ndjenjë humanizmi, krijimtarije dhe komunikimi të gjeneratave të reja për zhvillimin e vlerave, sistemeve dhe shoqërive të ndryshme.

*AE do të njihet për:*

Edukim ndërdisiplinor, eksperimental, i individualizuar dhe inovativ i fokusuar në zhvillimin personal dhe profesional të studentëve të pasionuar, punëtorë, ambiciozë dhe krijues të të gjitha moshave;

- Avokimi i AE për artin, dizajnin dhe sipërmarrjen krijuese;
- Diversiteti, qasshmëria dhe barazia e AE'së në gjithçka që bëjmë;
- dhe shërbimi i AE'së për komunitetin tonë në vënd, rajon dhe më gjërë.

## 1.3 Objektivat

Objektivat kryesore të AE janë:

- Të afirmohet si institucion i vlerësuar i arsimit të lartë në Kosovë dhe më gjerë, i njohur për zhvillimin dhe avancimin e ideve të reja krijuese, ideve shkencore dhe arsimimit të gjithmbarshëm;
- Të zhvillojë dhe të zgjerojë vazhdimisht veprimtarinë e vet mësimore në përputhje me standardet bashkëkohore në fushën e arsimit të lartë profesional;
- Të arrijë nivel sa më të lartë profesional të arsimimit të specialistëve në fushën e artit aplikativ, dizajnit, shkencës dhe kulturës nëpërmjet të një procesi të gjithanshëm të mësimdhënies, hulumtimeve, aktiviteteve artistike dhe projekteve kreative;
- T'i ofrojë tregut vendor dhe të rajonit profesionistë të kualifikuar në fushën e arteve të aplikuara dhe dizajnit në pajtim me zhvillimet ekonomike, si dhe industriale në rajonale dhe më gjerë;
- Të ushtrojë veprimtari komerciale në lëminë e arteve të aplikuara dhe dizajnit;
- Të ndihmojë në avancimin dhe forcimin e pozitës së vajzave dhe grave në shoqëri;
- Të forcojë vetëdijen e përgjegjësisë sociale të stafit dhe studentëve dhe të vazhdojë të jetë kontribues i

rëndësishëm në aktivitetet me interes të komunitetit.

- Të jetë një zë i fuqishëm në mbrojtje të kauzave, dukurive dhe grupeve të marginalizuara etj.,

## **2. Strategjia për arritjen e misionit dhe objektivave të Akademisë “Evolucion”**

AE ka përcaktuar strategjinë e vet për arritjen e misionit dhe objektivave të saj. Strategjia është aprovuar nga Këshilli Drejtues në bashkëpunim me menaxhmentin dhe udhëheqësit e departamenteve të AE. Ajo rishikohet dhe përditësohet periodikisht në pajtim me ndryshimet e vazhdueshme në vend dhe jasht.

Strategjia e zhvillimit të AE është e përqendruar në pikat/lëmitë e paraqitura në vijim:

- A) Programet e studimit;**
- B) Kërkimi, inovacioni dhe praktika krijuese**
- C) Staf akademik dhe administrativ;**
- D) Sudentët;**
- E) Monitorimi i ndryshimeve; dhe**
- F) Bashkëpunimi dhe ndërveprimi.**
- G) Përgjegjësia sociale**

Secila pikë/lëmi konsiston në objektiva specifike dhe pika të veprimit për arritjen e tyre.

### **A. Programet e studimit-Ekselenca në mësimdhënie**

Në të gjitha departamentet tona, ne ofrojmë mundësi për studentët tanë që, përveç marrjes së njohurive teorike-kritike për dizajnin dhe artet e aplikuara, të fitojnë aftësitë e nevojshme dhe përvojën e vlefshme për t'u formuar si profesionistë të pavarur, të gatshëm për t'u përshtatur gjithnjë e më shumë kërkesave dhe dinamikës të tregut.

#### ***A.1 Forcimi i programeve ekzistuese dhe zhvillimi i programeve të reja, me qëllim të përmbushjes së nevojave të komunitetit dhe biznesit***

1. Investimi i burimeve financiare dhe njerëzore për të forcuar dhe mbështetur programet aktuale;
2. Zhvillimi dhe kryerja e hulumtimeve/anketave për të identifikuar dëshirat dhe nevojat e komunitetit dhe të biznesit. Zhvillohen hulumtime/anketime të veçanta për banorët e komunitetit dhe sektorin e biznesit.
3. Zhvillimi i partneritetit me institucionet relevante (Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, Dhomat e Tregtisë, OJQ-të etj.) për të hulumtuar trendet e punësimit në zhvillimin e ekonomisë së vendit.
4. Mbajtja e pozicionit të institucionit konkurrues në mjedisin e arsimit dhe përgatitja e studentëve për t'u bërë edhe ata profesionistë konkurrues në tregun e punës, duke inkorporuar arritjet e teknologjisë aktuale në programet tona.

## ***A.2 Zhvillimi i programeve dhe rekrutimi i studentëve, që i përgjigjen drejtpërdrejt trendeve aktuale dhe atyre të parashikuara të tregut***

1. Shtimi i rekrutimit/regjistrimit të studentëve, sidomos për lëmitë e pashërbyera, të identifikuar në hulumtimet e tregut;
2. Trajnimi i personelit përkatës të AE për të komunikuar informacionet rreth programeve të Akademisë "Evolucion", për t'i tregtuar ato në komunitet dhe për të promovuar mundësitë e partneritetit.
3. Përfshirja e departamenteve dhe personelit përkatës në aktivitetet promovuese në shkollat e mesme, për të punuar me nxënësit, personelin përgjegjës shkollor dhe për të prezantuar programet e AE prindërve;
4. Të vazhdohet me programet e koordinuara të marketingut në shkollat e mesme;
5. Rritja e numrit dhe mbështetjes për aktivitetet dhe grupet e interesit të studentëve;
6. Krijimi i kurseve përgatitore, që mund të shërbejnë si një orientim në kurset e kredituara për studentët;
7. Të shtohen programe/kurse të reja në nivel certifikimi dhe të gradave (diplomave) përkatëse;
8. Të vazhdojnë kërkimet/hulumtimet e trendeve demografike dhe tendencave ekonomike;
9. Zhvillimi dhe promovimi një broshurë akademike me pamje profesionale, që paraqet dhe shpjegon programet aktuale dhe rrugët e karrierës së studentëve;

## **B. Kërkimi, inovacioni dhe praktika/veprimtaria krijuese**

Misioni ynë kërkimor është të zhvillojmë një kulturë kërkimore të avancuar dhe të qëndrueshme që do të mbështesë procesin tonë të mësimdhënies dhe të të nxëniet, do të frymëzojë kreativitetin dhe mendimin kritik tek studentët tanë, do t'i mundësojë stafit akademik të arrijë përsosmëri dhe do të rrisë statusin kombëtar dhe rajonal të AE-së përmes kontributit që kërkimi ynë jep në arte, kulturë dhe komunitet.

Gjatë pesë viteve të ardhshme, ne jemi të përkushtuar në realizimin e objektivave strategjike të kërkimit, planeve të veprimit dhe zhvillimit të treguesve kryesorë të performancës për të matur zbatimin e Planit Strategjik:

### ***B.1 Promovimi i kërkimit të aplikuar përmes praktikës krijuese dhe eksperimentimit.***

1. Fokusimi i aktiviteteve kërkimore në fushat prioritare (dizajni i modës, dizajni i komunikimit).
2. Themelimi dhe zhvillimi i laboratorëve kërkimorë ndërdisiplinorë në dizajn, modë dhe artet e komunikimit.
3. Inkurajimi dhe mbështetja e pjesëmarrjes në programet kërkimore krijuese rajonale dhe të financuara nga BE-ja (p.sh., Creative Europe, Erasmus +, etj).
4. Njohja e rezultateve krijuese (vepra arti, performanca, prototipa, ekspozita) si rezultate të vlefshme kërkimore.

5. Zhvillimi i kritereve të qarta të vlerësimit për kërkimin e bazuar në praktikë.
6. Integrimi i rezultateve të kërkimit në mësimdhënie, ekspozita dhe ngjarje artistike.

### ***B.2 Forcimi i mbështetjes institucionale për stafin akademik dhe studentët për të ofruar rezultate kërkimore me ndikim të lartë***

Për të mbështetur këtë objektiv strategjik janë planifikuar veprimet e mëposhtme:

1. Rritja graduale e buxhetit institucional për financimin e kërkimit
2. Ofrimi i trajnimit për stafin akademik për kryerjen e kërkimit në fushat e arteve të aplikuara dhe dizajnit përfshirë metodologjitë e kërkimit dhe publikimin e rezultateve në revista ndërkombëtare me recenzion nga kolegët.
3. Inkurajimi i partneriteteve të reja kërkimore dhe mundësive të financimit (duke përfshirë partneritetet në projekte ndërkombëtare dhe industri), që i përgjigjen nevojave të komunitetit;
4. Rritja e mbështetjes institucionale kërkimore për shkrimin e granteve, menaxhimin e projekteve dhe administrimin e kërkimit;
5. Zhvillimi i një Rregulloreje mbi Ekuivalencën e Kërkimit Artistik të Aplikuar dhe Praktikës Kreative me Kërkimin Akademik për të shërbyer si një kornizë për promovimin dhe vlerësimin e stafit.
6. Zhvillimi dhe monitorimi i një sërë treguesish kryesorë të performancës (KPI) për aktivitetet dhe rezultatet e kërkimit.

### ***B.3 Rritja e profilit dhe dukshmërisë së arritjeve kërkimore në nivel lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar;***

1. Forcimi i mbështetjes institucionale për prezantimet publike si ekspozitat, konferencat dhe format e tjera të shpërndarjes së rezultateve të kërkimit;
2. Prezantimi dhe promovimi i arritjeve të kërkimit në fushën e edukimit dhe të arsimimit brenda vendit (brenda AE) dhe jashtë tij (te partnerët dhe komuniteti);
3. Inkurajimi dhe mbështetja e zhvillimit të projekteve kërkimore më të bazuara në komunitet, me pjesëmarrje të shoqërisë, me synim rritjen e ndikimit social të kërkimit
4. Promovimi i projekteve të kërkimit të aplikuar që gjenerojnë zgjidhje inovative dhe mundësi ndërmarrësie në dizajn;

5. Thellimi dhe zgjerimi i bashkëpunimeve kërkimore me institucione të tjera - akademi, universitete dhe kolegje, si brenda Kosovës ashtu edhe ndërkombëtarisht.

Përmes këtyre veprimeve, AE synon të nxisë një kulturë të gjallë të kërkimit dhe inovacionit artistik të aplikuar, ku kërkimi dhe praktika artistike njihen si pjesë integrale e përsosmërisë në mësimdhënie dhe avansimit shoqëror.

### **C. Staf i akademik dhe administrativ**

AE do të investojë vazhdimisht në pasurimin e departamenteve me staf akademik kompetent dhe profesional. AE synon të gjejë kombinimin më të mirë të mësimdhënësve me përvojë dhe biografi të pasur me aktivitete, projekte artistike dhe krijuese, specialistë të provuar në këto fusha si dhe ligjërues të rinj, të arsimuar në vend dhe jashtë vendit, të cilët sjellin njohuri dhe përvoja të reja të institucioneve në të cilat ata formohen.

Përsosmëria në shërbimet profesionale, që mbështesin stafin akademik dhe studentët është një parakusht i domosdoshëm për suksesin e tyre. Staf i profesional, i aftë teknikisht dhe i përkushtuar personalisht në arsim dhe hulumtim dhe i mbështetur në vlerat institucionale të Akademia "Evolucion", është thelbësor për punën tonë.

#### ***C.1 Sigurimi i mundësive të reja për zhvillimin e stafit akademik për të mbështetur një atmosferë të ekselencës në mësimdhënie dhe në mësimnxënie***

1. Të gjenden burime shtesë financiare për të mbështetur pjesëmarrjen stafit akademik në seminare / punëtori / konferenca, në kuadër të ekspertizës dhe fushëveprimit të tyre;
2. Organizimi i punëtorive në mësimdhënie në klasë dhe në strategjitë e mësimi. Punëtoritë mund të ofrohen nga ekspertë të jashtëm ose nga ligjërues dhe ekspertë të stafit të AE
3. Zhvillimi i programeve të reja të përqendruara në mësimdhënie dhe mësim. Të bashkëpunohet me universitetet dhe kolegjet e tjera për të zhvilluar takime disiplinore dhe aktivitete të tjera të përbashkëta;
4. Mbështetja e aktiviteteve ekzistuese dhe zhvillimi i atyre të reja si dhe mbështetja e zhvillimit profesional të fokusuar në mbështetjen e studentëve. Të bashkëpunohet me universitetet dhe kolegjet e tjera për të zhvilluar takime të gjera të mbështetjes së studentëve si aktivitete të zhvillimit profesional;

5. Inkurajimi dhe vazhdimi i mbështetjes së stafit akademik në zhvillimin dhe qëllimet e tyre arsimore, si financiarisht ashtu edhe me orar fleksibil;
6. Mbështetja e programeve të zhvillimit të personelit mësimor që iu ndihmojnë atyre në përmbushjen e qëllimeve të Akademisë.

### ***C.2 Sigurimi i mundësive të reja për zhvillimin e stafit administrativ për të mbështetur procesin mësimor dhe shërbime efikase të studentëve***

1. Përkrahja dhe zhvillimi i stafit administrativ që mundëson Sigurimin e funksionimit efikas të proceseve akademike dhe administrative;
2. Mbështetja e stafit administrativ për të ofruar shërbimeve cilësore, të orientuara drejt studentëve dhe palëve të interesit;
3. Inkurajimi i mëtejshëm i stafit administrativ për mbështetjen e misionit krijues dhe të bazuar në projekte të arsimit aplikativ që ofrohet në AE.

## **D. Studentët**

Në institucionin tonë, studentët kanë mundësinë për të arritur qëllimet e tyre arsimore, duke iu ofruar mësim cilësor në përgjithësi, edukim në karrierë dhe shkathtësitë themelore si dhe aktivitete që nxisin zhvillimin e tyre personal dhe suksesin akademik. Ne i japim përparësi të lartë marrëdhënieve mbështetëse të mësimdhënies dhe mësimnxënies të mësimdhënësve / stafit administrativ me studentët, shërbimeve mbështetëse të përgjegjshme dhe mjedisit kurrikular që kontribuon në rritjen personale dhe suksesin e studentëve.

### ***D.1 Përmirësimi i suksesit, mbajtjes ("retention"), këmbënguljes ("persistence") dhe shkallës së transferimit ("transfer rate") të studentëve***

1. Të vlerësohet vazhdimisht efektiviteti i programeve tona, duke përfshirë pengesat për suksesin, mbajtjen, shkallën e transferimit dhe këmbënguljen e studentëve;
2. Të zhvillohen mënyrat për të ndërlidhur stafin akademik, stafin administrativ dhe grupet e studentëve për të punuar si pjesë e një ekipi mbështetës të studentëve për studentët në nevojë;
3. Të zhvillohet një sistem i komunikimit me të gjithë ata studentë që kalojnë testet e pranimit, por nuk regjistrohen;
4. Të zhvillohet strategjia për të rritur gjasat e regjistrimit nga një semestër/vit në tjetrin;
5. Përforcimi dhe promovimi i imazhit të AE si një institucion i transferimit të suksesshëm;

6. Krijimi i mundësive përmes të cilave, studentët mund të lëvizin përmes programeve të transferimit në kohën e duhur;
7. Shtimi i përdorimit të mediave elektronike për të komunikuar me studentët e mundshëm të transferimit.
8. Të zhvillohen programet e praktikës profesionale dhe mentorimit për studentët tanë;
9. Të krijohet shërbimi për ndihmë në punësim;
10. Të zhvillohen shtigjet e karrierës për studentët;

***D.2 Ndërtimi i një mjedisi edukativ që nxit pasionin për arsimin, udhëheqjen dhe aftësitë personale, të nevojshme për angazhim / pjesëmarrjen qytetare***

1. Të zhvillohen kurse akademike rigoroze me strukturë të tillë që mbështesin studentët e nën-përgatitur p.sh. grupet e studimit dhe përkrahja nga studentët kolegë;
2. Të ofrohen mundësitë për studentët që të zhvillojnë marrëdhënie akademike me ligjëruesit edhe jashtë procesit mësimor obligativ;
3. Krijimi i një mjedisi me plot aktivitete dhe i mbushur me ide dhe debate;
4. Të ofrohet mbështetje për klubet e studentëve;
5. Të krijohen hapësira fizike në kampus për përdorim ekskluziv të studentëve;
6. Zhvillimi i një zyre pranimi dhe regjistrimi miqësore dhe të arritshme (qasshme);
7. Ofimi i këshillimeve të shpeshta për fushat e caktuara të studimit ose karrierës;
8. Ofrimi i mundësive për studentët për bashkëveprim me kolegët/et me prejardhje ("background") të ndryshme;
9. Krijimi i mundësive për studentët që të angazhohen në mësimin e shërbimit ("service learning");
10. Sigurimi i financimit nga jashtë (granteve) për aktivitete dhe programe për angazhimin e studentëve dhe për promovimin e diversitetit.

**E. Përshtatja ndaj ndryshimeve**

AEvazhdimisht monitoron zhvillimet, trendet dhe kërkesat e tregut në fushat e mbuluara nga programet tona. Këto ndryshime ndiqen përmes pjesëmarrjes aktive në këto ngjarje dhe ato merren parasysh dhe reflektohen në programet tona dhe aktivitetet e tjera mësimore (siç janë projektet e artit, pjesëmarrja në gara, ekspozita, etj.).

***E.1 Të gjitha vendimet për programet dhe kurrikulat bazohen në strategjitë udhëhequra nga të dhënat***

1. Të përdoren të dhënat për të bërë ndryshime në programe, kurrikula, orare dheshërbime studentore, duke përfshirë një analizë të përfitimeve të kostos;
2. Të analizohen ndryshimet në preferencat dhe qëndrimet e studentëve si dhe ndryshimet sociale, ekonomike dhe teknologjike në tregun e synuar;
3. Të identifikohen grupet e studentëve dhe të përcillet progresi i tyre në institucion dhe më pas. Të përdoren të dhënat e progresit të studentëve dhe të përfundimit të studimeve në procesin e rishikimit të programeve;
4. Të zhvillohet partneritetet me entitetet e tjera për të mbledhur të dhëna kyçe për nevojat dhe tendencat potenciale të studentëve;
5. Të kërkohen në mënyrë aktive segmentet e tregut si rezultat i analizës së konkurrentëve dhe hulumtimeve të vazhdueshme.

## **F. Bashkëpunimi dhe ndërveprimi**

*(me institucionet arsimore, bizneset dhe individët krijues)*

AE komunikon dhe bashkëpunon me institucionet arsimore brenda dhe jashtë vendit duke përfituar nga shkëmbimi i ideve dhe informacioneve rreth zhvillimeve më të fundit në fushat përkatëse të studimit. Ne do të sigurojmë që organizatat që kërkojnë të bashkëpunojnë me AE kanë një pikë të vetme të kontaktit, duke mundësuar lidhje të shpejtë dhe efektive dhe me rritje të gjasave të bashkëpunimit me to.

Përveç mësimin në mjediset e shkollës, AEu siguron studentëve dhe personelit mësimdhënës qasje të drejtpërdrejtë në kompani të specializuara në fushat përkatëse të kërkimit dhe në projekte komerciale. Në këtë mënyrë, studentët tanë kanë mundësi të aplikojnë njohuritë dhe aftësitë e tyre dhe t'i përsosin ato.

*Bashkëpunimi me individët krijues - rrjeti kreativ* - AE është i hapur për komunikim dhe bashkëpunim me individë krijues nga brenda dhe jashtë vendit. Për këtë qëllim, AEA krijuar një rrjet krijues "Evolart", përmes të cilit, ftohen ligjërues mysafirë nga vendi dhe jashtë vendit. Temat e ligjërave organizohen për studentët dhe ligjëruesit e shkollës, pas së cilave vazhdon debati i hapur mbi temat aktuale

### ***F.1 Zhvillimi dhe forcimi i marrëdhënieve bashkëpunuese dhe partneriteteve me institucionet arsimore brenda dhe jashtë vendit***

1. Të vlerësohen partneritetet ekzistuese dhe në bazë të tyre të përcaktohet se si mund të përmirësohen programet;
2. Të krijohen partneritete që pasqyrojnë nevojat e ekonomisë aktuale dhe të lëmisë së shërbimit;
3. Të inkurajohen kontaktet e vazhdueshme me shkollat e mesme për identifikimin dhe zhvillimin e kompetencave të kërkuara për suksesin e studentëve në AE

4. Harmonizimi dhe përshtatja e kurrikulave të Akademia "Evolucion", zhvillimi i vlerësimeve të përbashkëta dhe zhvillimi i programeve për të rritur ndërgjegjësimin e studentëve rreth karrierës së tyre dhe mundësive akademike të disponueshme në AE

5. Rritja e aftësisë për informim dhe komunikim në mes të stafit mësimdhënës të AE dhe atij të shkollave të mesme

***F.2 Të mbështeten dhe të forcohen programet ekzistuese në dialog me biznesin dhe industrinë. Përmes kërkimit dhe ndërveprimit të qëndrueshëm me komunitetin e biznesit, të gjurmohen programe dhe kurse të reja, që pasqyrojnë nevojat dinamike profesionale dhe specifike të tregut lokal dhe rajonal***

1. Të ndërtohen dhe mbahen marrëdhëniet me Odat e Tregtisë dhe Departamentet e Zhvillimit Ekonomik të institucioneve lokale dhe qeverisë qendrore;
2. Të zhvillohen i partneritete me industrinë lokale;
3. Të zhvillohet partneriteti me industrinë për praktikën profesionale dhe për punësim të studentëve.
4. Të zhvillohen programet e përshpejtuara dhe fleksibël, për të përmbushur nevojat e komunitetit të fuqisë punëtore;
5. Të zhvillohet dhe mbahet partneriteti me korporatat dhe organizatat tjera shoqërore për të identifikuar nevojat arsimore aktuale dhe ato në zhvillim dhe mundësitë e trajnimit;

**Aspiratat dhe rezultatet:**

- Strategjitë e zhvillimit dhe investimin në kërkime të njohura ndërkombëtarisht dhe zhvillimin e programeve të bursave.
- Zgjerimi i bashkëpunimeve me Universitete dhe kolegje të tjera për zhvillime akademike ndërdisiplinore dhe Hulumtime.
- Krijimi i një infrastrukturë kërkimore efikase dhe mbështetëse në të gjithë AE, duke përfshirë staf teknik dhe infrastrukturë me pajisje bazë.
- Zhvillimin e një bërthamë të arteve liberale të orjentuar nga kërkimi në kontekstin global të shekullit të 21-të që mban ritmin me kërkimin shkencor në zhvillim në Arte dhe Dizajn, i përshtatshëm ndaj diversitetit kulturor, angazhon nxënësit me një mendim kritik të botës komplekse ku ata banojnë.
- Zhvillimi dhe ruajtja e një institucioni të arsimit të lartë dhe stafi më të larmishëm, duke u krahasuar me standardet dhe normat kombëtare dhe ndërkombëtare.
- Mbajtja në nivel të lartë të programeve të forta të diplomimit që do të kontribuojnë në një mjedis akademik konkurrues.
- Rritja e shërbimeve këshilluese për të mbështetur në mënyrë efektive përparimin akademik të studentëve, përgatitjen e tyre për sukses në një gamë të gjerë karrierash profesionale.
- Rritja e mundësive të zhvillimit dhe avancimit të stafit që do të ndihmojnë në mbajtjen e një ekipi më të fortë të punonjësve.

## **G.Përgjegjësia Sociale**

Plani ynë i Përgjegjësisë Sociale dhe Angazhimit Qytetar ka pesë prioritete: përfshirje sociale, komunitete të begata, shëndet më të mirë, qëndrueshmëri mjedisore dhe angazhim kulturor. Në zbatimin e planit tonë strategjik, ne do të veprojmë në mënyrë etike, transparente, të qëndrueshme dhe për përfitimin e gjerë publik në çdo kohë.

Ky angazhim i gjerë ndaj përgjegjësisë sociale dhe qëndrueshmërisë do të formësojë politikën, praktikën dhe respektin për mjedisin tonë. Ne do të përfshijmë studentët tanë, stafin akademik dhe administrative, keshillat, të diplomuarit, partnerët dhe komunitetet tona më të gjera në zhvillimin dhe ofrimin e veprimeve dhe strategjive të kërkuara për ta përfshirë këtë pjesë kaq të rëndësishme në aktivitetet tona të përditshme.

Ne besojmë se përgjegjësia sociale është një pjesë e trungut tonë e skalitur thellë e cila tashmë përshkon pjesën më të madhe të asaj që ne bëjmë, por ne e pranojmë se kjo është hera e parë që AE do të vendosë dukshëm përgjegjësinë sociale në zemër të strategjisë së planit.

## **Monitorimi i ndryshimeve**

Zbatimi i këtij Plani Strategjik do të monitorohet çdo vit nga Këshilli Akademik dhe Zyra për Sigurimin e Cilësisë. Progresi do të matet përmes IKP-ve të paracaktuara dhe do të raportohet në Raportin vjetor të Përmirësimit të cilësisë.